



Testimi për Diskriminimin:

Identifikimi dhe ndjekja penale mbi Shkeljen e të drejtave të njeriut



Nga: Bea Bodrogi
Redaktuar: Liam Mahony

Doracak taktik, publikuar nga:
Projekti mbi taktikat të reja
të Qendrës për Viktimat e Torturuara



Publikuar nga

The Center for Victims of Torture
New Tactics in Human Rights Project
717 East River Road
Minneapolis, MN 55455 USA
www.cvt.org, www.newtactics.org

Redaktor i Serive të manualit

Liam Mahony

© 2003 Center for Victims of Torture

Ky publikim lirshëm mund të behet kopje si dhe të shpërndahet në formë elektronike me kusht që shenja © të shfaqet në të gjitha kopjet.

Mbështetje dhe përkrahje serive të doracakut taktik

Seria e doracakut taktik është përpiluar me ndihmën e donatorëve vijues: United States Institute of Peace (Instituti Amerikan për Paqe), National Philanthropic Trust, Organization Security and Cooperation in Europe (Organizata për Siguri dhe Kooperim në Evropë), United States Department of State (Departamentit i Shteteve të Bashkuara) the Sigrid Rausing Trust (ish Ruben and Elisabeth Rausing Trust), John D. and Catherine T. MacArthur Foundation, dhe fondacioni nga një donator individual i cili dëshiron të mbetet anonim.

Si shtesë, King Baudouin Foundation ka siguruar një grant për partnerin tonë, ICAR në Rumani për të mbështetur punëtorinë trajnuese regjionale të mbajtur atje dhe për të prodhuar doracakët taktik nga pjesëmarrësit e punëtorisë.

Mohim i përgjegjesisë

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport jo domosdoshëm reflektojnë ato të taktikave të reja në projektin e të drejtave të njeriut ose të donatorëve të tyre. Projekti nuk i gjykon taktikat apo politikatat specifike.

Përmbajtja

Parathënia e Redaktorit	6
Hyrje	7
Përvetësimi i mjetit i marrë nga përvoja Anti-Diskriminuese në SHBA	7
Situata e pjesëtarëve romë që jetojnë në Hungari	8
Taktika e Testimit	8
Shembull: Rasti Lajos Baloghi	12
Rezultatet	13
Aplikimi i taktikes për rastet gjyqësore	14
Përdorimi i taktikes së testimit në mënyra tjera	15
Përfundim	15



The Center for Victims of Torture
New Tactics in Human Rights Project
717 East River Road
Minneapolis, MN 55455 USA
newtactics@cvt.org
www.newtactics.org





Prill 2003

I Nderuari Mik,

Mirë se vini në serinë e Doracakut mbi taktikat, si dhe projektin e Taktikave të reja të të drejtave të njeriut! Në secilin doracak të praktikave të të drejtave të njeriut përshkruhen inovacionet e taktikave që ishin të suksesshme në avancimin e të drejtave të njeriut. Autorët janë pjesë të bordit dhe lëvizjeve të ndryshme të të drejtave të njeriut, përfshirë edukatorët, bibliotekarët, punëtorët e shërbimit shëndetësor, personelin për zbatim të ligjit, avokatët e të drejtave të grave.

Secili doracak përmban informata të detajuara lidhur me atë se çka ka arritur autori/ja dhe organizata me punën e tij/saj. Ne dëshirojmë që praktikantët e të drejtave të njeriut t'i inspirojmë që të mendojnë në mënyrë taktike, të reflektojnë mbi taktikat që ata kanë zgjedh, të implementojnë strategjinë e gjerë të tyre, t'i zgjerojnë sferat e taktikave që konsiderohen të efektshme, si dhe t'i avancojnë të drejtat e njeriut.

Në këtë doracak, autori demonstroi që taktikat efektive mund të transferohen dhe adaptohen në situata dhe vende të tjera. NEKI – Zyra ligjore për mbrojtjen e minoriteteve etnike dhe nacionale (Legal Defence Bureau for National and Ethnic Minorities) në Hungari ka mësuar rreth testimit të taktikave nga një grup i SHBA të cilët kanë vërtetuar suksesshëm instancën e diskriminimit të banimit duke dërguar "testuesit" e racave të ndryshme që të aplikojnë për apartamente. Gjithashtu, diskriminim i ngjashëm është shfaqur në Hungari kundër popullatës romë – në banim, punësim, qasje në hapësira publike, shërbime publike dhe sfera të tjera. NEKI ka adaptuar taktikën e testimit për t'u futur në strategjinë e përdorimit të proceseve gjyqësore për t'i sfiduar shkeljet e të drejtave të njeriut. Jo vetëm që kjo taktikë ka vërtetuar të jetë e aplikueshme në Hungari ngjashëm me atë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjithashtu është vërtetuar efektive në situata të tjera përveç atyre të diskriminimit të banimit.

Të tëra seritë e Doracakut taktik do të jenë në dispozicion onlajn në ueb faqen www.newtactics.org. Në ueb faqen tonë gjithashtu do të gjeni mjete të tjera, përfshirë bazën e të dhënave të taktikave, një forum debatesh për praktikantët e të drejtave të njeriut, dhe informata rreth punëtorëve dhe simpoziumeve tona. Për t'u qasur në Buletin elektronik informativ të taktikave të reja ju lutemi të na dërgoni një email në newtactics@cvt.org.

Taktikat e reja në projektin e të drejtave të njeriut është një iniciativë ndërkombëtare e udhëhequr nga grupe të ndryshme të organizatave dhe praktikantëve nga tërë rruzulli tokësor. Projekti është i koordinuar nga Qendra për Viktimat e Torturës (Center for Victims of Torture, CVT), dhe është zgjeruar në bazë të përvojave tona si kreator i taktikave të reja dhe trajtimit të qendrës e cila gjithashtu avokon për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga pozita unike – shëruese dhe korrigjuese e lidershipit civil.

Shpresojmë që ju do ta konsideroni këtë doracak mjaftë informues dhe provokues në të njëjtën kohë.

Sinqerisht e juaja

Kate Kelsch

Menaxhere e Projektit Taktikat e reja

Bea Bodrogi

Bea Bodrogi ka punuar për 6 vite si juriste që është marrë me rastet e të drejtave të njeriut. Ajo ka kryer magistraturën në drejtësi në shkollën ekonomike të Londrës (London School of Economics), ku ajo është fokusuar mbi mbrojtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, rregullimin ligjor të diskriminimit si dhe zgjidhjet alternative të konflikteve.

Bea punon si avokate për NEKI në Zyrën ligjore për mbrojtën e minoriteteve etnike dhe nacionale (Legal Defence Bureau for National and Ethnic Minorities), administrimin e rasteve mbi diskriminimin etnik, është e angazhuar në misionet për gjetjen e fakteve dhe përpilimin e raporteve për të drejtat e njeriut - Manualet e bardha 1996-2002 (White Booklets 1996-2002). Bea gjithashtu ka punuar mbi rastet të cilat janë dorëzuar në Gjykatën Evropiane për të drejtat e njeriut, ligjëron dhe publikon gjerësisht mbi çështjet diskriminuese. Përveç që punon në NEKI, Bea ligjëron në Fakultetin Juridik në Debrecen lidhur me zgjidhjen alternative të konflikteve. Ajo gjithashtu është e angazhuar me punë në Komitetin e Helsinkit dhe në Shoqatën për mbështetjen e Homoseksualëve dhe Lezbikeve në Hungari.

NEKI- Zyra Ligjore për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike dhe Nacionale

NEKI ka për qëllim të mbrojë minoritetet etnike dhe nacionale që jetojnë në Hungari. Organizata siguron asistencë ligjore në rastet e diskriminimit bazuar në origjinën etnike ose nacionale të viktimës, ose në raste të rëndësishme të implementimit të rregullës së ligjit. Raporti vjetor i NEKI-it i quajtur "Manuali i bardhë" (White Booklet) përshkruan disa nga rastet më të rëndësishme.

Informatat Kontaktues

Legal Defense Bureau for National and Ethnic Minorities (NEKI)
MASSAG Foundation
H-1537 Budapest 114, P.O.Box 453/269, Hungary

Parathënia e Redaktorit

Ky doracak taktik fokusohet mbi transplantimin e suksesshëm të "testimit" në Hungari, taktikë kjo e zhvilluar në Shtetet e Bashkuara. Në testim, një organizatë për avokim që ka pranuar një ankesë lidhur me një incident të diskriminimit, menjëherë ka dërguar "testuesit" të përsërisin incidentin. Për shembull, nëse personit i është mohuar e drejta për punësim në bazë të identitetit të tij, "testuesit"¹ menjëherë dërgohen të aplikojnë për të njëjtën punë dhe dokumentojnë trajtimin e tyre. Ky dokumentacion do të legjitimojë evidencën e natyrës sistematike të diskriminimit.

Organizatat në Shtetet e Bashkuara që kanë luftuar për ndarje të paanshme të banesave, kanë zhvilluar këtë taktik për të luftuar praktikat diskriminuese gjatë shitjes apo dhënies me qira të shtëpive. NEKI në Budapest ka adaptuar këtë për t'i mbrojtur të drejtat e pjesëtarëve të popullatës rome, të cilët janë në mënyrë sistematike të mohuar nga qasja në vende të punës si: në restorante, vende tjera publike, etj.

Kudo që ekziston diskriminimi kundër minoriteteve, qoftë në banim, punësim, apo qasje publike, avokatët shpesh ballafaqohen me vështirësi për t'i sfiduar të vërtetat në gjyq. Një ngjarje e vetme mund të sqarohet tutje si një "gabim" ose "gabim i individit" dhe veprimi shpesh justifikohet me anë të krijimit të "arsyeve" si konteste specifike. Avokatët konfrontojnë këtë dhe shpesh ata duhet të vërtetojnë jo vetëm që akti diskriminues ka ndodhur, por që edhe motivi prapa veprimit ishte diskriminues, dhe që diskriminimi është i një natyre sistematike. Testimi është taktik që plotëson këtë nevojë, ndihmon procesin dhe daljen në gjyqë edhe në sistemet gjyqësore që nuk inkurajojnë rastet anti-diskriminuese.

Ky doracak jo vetëm që paraqet leverdinë e kësaj taktike, por gjithashtu demonstroi me anë të shembujve sesi taktikat mund të adaptohen nga rrethanat e ndryshme dhe mund të përdoren në mënyrë efikase në luftë për të drejtat e njeriut gjithkund në botë.

- Liam Mahony, botues i serive të doracakut

¹Testuesit janë persona fizik, kontrollor, provues.

Hyrje

Zyra ligjore për mbrojtjen e minoriteteve etnike dhe nacionale (NEKI) është themeluar në vitin 1994 si kundërpërgjigje ndaj problemeve të shkaktuara nga paragjykimet e vjetra kundër popullatës rome, grupit minoritar më të madh në Hungari. NEKI synon të dokumentojë përvojën e diskriminimit dhe të demonstrojë mungesën e mbrojtjes ligjore për pakicën rome. Organizata është e angazhuar me rastet, duke përfshirë brutalitetin e policisë, sulmeve raciste dhe mohimin e punësimit, banimit, dhe shërbimit në sektorin e strehimit publik. Pasi që shpesh diskriminimi është delikat, atëherë edhe evidenca direkte është e rrallë. Duke adaptuar metodën që përdoret nga organizatat në SHBA, NEKI përdorë testimet për mbledhjen e fakteve me të cilat pastaj do ta sfidojë diskriminimin në gjyq. Pas një incidenti të diskriminimit të raportuar në NEKI nga një viktimë rome, testuesit – romë dhe jo romë – janë dërguar që të përsëritin përvojën në mënyrë që të dokumentohet nëse incidenti përfaqëson rastin e diskriminimit sistematik, dhe të mbledhë evidencë për rast të mundshëm gjyqësor.

Përvetësimi i mjetit i marrë nga përvoja Anti-Diskriminuese në SHBA

Një kolegë i NEKI-it ka kaluar një vit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke studiuar dhe marrë përvoja praktike për të drejtat e njeriut. Gjatë kësaj periudhe ai ka punuar në Uashington D.C në departamentin për strehim të komunës "Council Housing Fair"¹, i cili ka përdorur testimin për të mbledhur evidencë të diskriminimit lidhur me strehimin.

Komuna teston praktikatat e agjentëve të pasurive të patundshme dhe pronarëve të cilët refuzojnë t'i japin me qira banesat ose t'i shesin shtëpitë për Afro-Amerikanët dhe për minoritetet e tjera. Kolegju ynë është kthyer me mjaft material të

Testimi është taktikë e mbledhjes së evidencës e cila mund të vendoset direkt në strategjinë ligjore të një organizate siç është NEKI, një organizatë që konfronton ndëshkimin dhe apatinë publike rreth mbizotërimit të problemit të racizmit dhe diskriminimit.

Procesi është fare i hapur: Njëherë kur NEKI pranon një ankesë, testuesit dërgohen te vendi ku ka ndodhur diskriminimi. Nëse deklarata ka të bëjë me punësimin, atëherë testimi bëhet kur dërgohet një person rom dhe një person që nuk është rom të cilët kanë karakteristika dhe kualifikime të njëjta, por që kanë përkatësi tjetër etnike. Ata dërgohen në një interval të shkurtër kohor në të njëjtën ditë që të aplikojnë për punë. Për ta bërë krahasimin sa më të qartë, nga secili testues është kërkuar që të ndërmarrin të njëjtat veprime të krahasueshme. Menjëherë pas kompletimit të testit ata kanë regjistruar përvojat e tyre mbi pyetjet e detajuara dhe përgjigjet që ata i kanë dhënë gjatë intervistës, trajtimin e kandidatit dhe përshkrimin e punës, përfshirë rrogat dhe përfitimet. Atëherë Koordinatori i testit mund të vlerësojë nga këto shënime dhe të vendosë nëse veprimi ligjor mund të iniciohet mbi bazat të diskriminimit.

pasur që përshkruan këtë proces. Sfidat janë të adaptuara në këtë situatë tonë.

Ne shumë shpejt kuptuam që kjo është saktësisht ajo çka ne kërkojmë dhe filluam të konstruojmë procesin tonë të testimit si dhe të adaptuajmë këtë për nevojat në Hungari. Situata e popullatës rome është e ndryshme nga ajo e minoriteteve në Shtetet e Bashkuara. Për shembull, në Hungari nuk do të ishte shumë e dobishme të mbledhet evidencë mbi diskriminimin në strehim apo banim sepse romët jetojnë në kushte shumë të vështira andaj ata rrallë marrin me qira dhe shume pak blejnë shtëpi ose banesa. Sidoqoftë, ne mund të aplikojmë testimin në rastet e diskriminimit në çështjet e punësimit dhe në sektorin publik. Meqenëse asnjë ligj nuk ndalon përdorimin e testimit, ne nuk shohim pengesa për të provuar që këtë ta aplikojmë.

¹The Fair Housing Council of Greater Washington: 1212 New York Avenue, NW, Suite 500, Washington, D.C. 20005

Situata e pjesëtarëve romë që jetojnë në Hungari

NEKI pranon më shumë se 100 ankesa në vit, shumica prej tyre kanë të bëjnë me popullatën rome të cilët ballafaqohen me diskriminim në të gjitha sferat e jetës së tyre. Duke konsideruar që romët janë minoritet shumë i cenueshëm dhe grup shoqëror i vendit, romët janë më se të përfaqësuar në të gjitha grupet shoqërore në nevojë për mbrojtje: të varfër, të papunësuar në afat të gjatë, të pakualifikuar, të paedukuar, anëtarë të familjeve të mëdha. Në shumicën e regjioneve të vendit ata ende jetojnë në periferi të qytetit, disa në vendbanime të izoluar nga shumica e popullatës jo rome. Me disa përjashtime, populli rom ka vuajtur nga ndryshimet ekonomike dhe sociale që kanë pësuar gjatë dhjetë viteve të kaluara. Gjatë procesit të tranzicionit, ata janë gjithmonë të parët që do të largohen nga puna dhe për shkak të mungesës së arsimit të tyre, ata rrallë herë kanë qasje në punë të re. Vetëm në qytetet e mëdha mund të gjenden disa të punësuar romë, dhe këta zakonisht janë të punësuar ilegalisht.

Që në fillim të viteve të 90-ta, komuniteti rom shpesh herë ka qenë cak i urrejtjes së krimeve. Sulmet raciste kundër romëve, në atë kohë, raportohesh çdo javë. Format e paragjyqimit ndaj këtij grupi minoritar, sidoqoftë ka ndryshuar që nga kjo periudhë. Në vend të sulmeve të hapura, format e fshehta të diskriminimit tani janë plotësisht të shtrira. Një punëdhënës kurrë nuk

deklarohet se ai nuk do ta punësojë një rom; ai më parë do të thotë që nuk ka vende të lira pune. Banakieri nuk do të pranojë që ai refuzon t'i shërbejë klientët në baza të origjinës etnike; ai do të arsyetohet se lokali është i mbushur përplot.

Për shkak të këtij detaji, dhe mungesës së rregullave ligjore joadekuate të diskriminimit, juristët gjatë proceseve gjyqësore të rasteve të të drejtave të njeriut kanë hasur në vështirësi gjatë mbledhjes së evidencës dhe vërtetimit të diskriminimit. Si plotësim, ligji Hungarez sa i përket rasteve të diskriminimit është shumë i dobët. Sipas Direktivës së fundit të Unionit Evropian, sa i përket diskriminimit racor, për shembull, nëse aty supozohet që ka pasur diskriminim direkt ose jo direkt, i pandehuri duhet të vërtetohet që aty nuk ka pasur shkelje të rregullës lidhur me trajtimin e barabartë. Por Hungaria nuk pajtohet me këtë kërkesë pavarësisht nga kritikën e disa raporteve të të drejtave të njeriut. Kështu që kur rastet e diskriminimit mbrohen në gjyq, ne duhet të zgjedhim metodën klasike që evidencën të vihet përpara, p.sh. një kandidat duhet të vërtetohet që ai është duke vuajtur nga diskriminimi. Kjo nuk është gjithnjë e lehtë të vërtetohet, dhe secili rast i paditësit natyrisht do të jetë më i fuqishëm nëse avokati ka lloje të ndryshme të evidencës për të demonstruar diskriminimin. Përdorimi i testimit na siguron një taktikë shtesë plotësuese në mbledhjen e evidencës për rastet e tilla, evidencë që është kritike për suksesin tonë në fitimin e rasteve diskriminuese.

Taktika e Testimit

Për implementimin e testimit të taktikës, duhet të ndërmerren një numër i hapave:

- Rekrutimi dhe seleksionimi i testuesve
- Trajnimi i testuesve
- Zbatimi i testimit
- Vlerësimi i rezultateve të testimit dhe marrja e vendimit nëse ato tregojnë diskriminim dhe nëse organizata do ta merr rastin
- Përdorimi i evidencës në gjyq

Te gjithë këta hapa do të përshkruhen në detaje.

Rekrutimi dhe Seleksionimi i Testuesve

Rekrutimi

Kur kemi vendosur të aplikojmë metodën në

Hungari, detyra jonë e parë ishte mbledhja e testuesve potencial. Për ne ishte e nevojshme lista e testuesve nga të cilët koordinatori i testit mund të zgjedh palët adekuate, kryesisht testuesit rom dhe ata që nuk ishin rom për secilin rast konkret. Ndonjëherë ne përdorim dy palë testues për të përcjellë një incident të vetëm (shikoni shembullin më poshtë të Lalos Balogh). Secilën herë kur kemi shfrytëzuar testuesit, jemi detyruar të zgjedhim persona të krahasueshëm me karakteristika dhe kualifikime të njëjta. Kjo për ne ishte e nevojshme për një pikënisje të mirë.

Për gjetjen e testuesve potencial, ne kryesisht mbështetemi në rrjetin tonë që ka ekzistuar më parë – studentë, kontakte personale, gazetarë dhe hulumtues. Është vërtetuar që studentët

kanë orar fleksibil dhe janë më të hapur në përgjithësi ndaj ideve të reja. Disa gazetarë, sidoqoftë ishin "shumë të entuziazmuar" dhe të etur për rezultate që ata të mund të raportojnë menjëherë në gazeta. Edhe pse raportimi i rezultateve është një pjesë e rëndësishme e procedurës së testimit, nevojitet një kohë e caktuar për publicitetin të tillë, si dhe duhet të zgjidhet me kujdes në përputhje me nevojat dhe jo sipas kritereve të gazetarit. Në shumicën e rasteve të të drejtave të njeriut, ne preferojmë të presim për procedurë ligjore për të pritur para lansimit të çfarëdo publiciteti sepse shumica e evidencës është mbledhur nga kjo kohë dhe ekziston rrezik më i vogël i çfarëdo akuzimi fals.

Mbështetja në kontaktet tona personale ka ngritur shumë probleme. Në rastin e fundit, një mik i Koordinatorit të testimit të NEKI-it ishte testues me pak i besueshëm. Koordinatori ka organizuar testimin e një bari në Budapest, ku popullata rome nuk është lejuar të futet brenda. Disa minuta para se të fillonte testimi, testuesi "mik" e anulon testimin, me arsyetim që diçka tjetër është më aktuale dhe se ai nuk mund të paraqitet. Testimi duhej të anulohet dhe disa personave i është urdhëruar që të kthehen në shtëpitë e tyre. Test-Koordinatori ka supozuar që mikun i saj ka menduar që ai mundet "t'ia lejoj vetes" të anulojë testimin në minutën e fundit edhe për arsye të papranueshme. Si plotësim, testuesit "miq" japin dëshmi në gjyq, të pandehurit mund të argumentojnë që dëshmitë e tilla janë të njëanshme dhe nuk duhet të merren parasysht. Ky problem ende nuk ka dalë në asnjë nga rastet gjyqësore, por është mirë të mos jepet çfarëdo arsye për vërejtje.

Ne ende nuk kemi pasur nevojë të zhvillojmë ndonjë nga procedurat, pasi që kemi qenë të aftë në mënyrë joformale të gjejmë mjaftë testues kur kemi pasur nevojë. Prezantimet tona të fundit publike lidhur me punën e NEKI-it dhe taktikave të testimit kanë krijuar mundësi rekrutimi me ardhjen e personave të ne dhe të na ndihmojnë vullnetarisht. Ne kemi vendosur që të mos rekrutojmë testues përmes shpalljeve për vende të lira, siç bëhet në Shtetet e Bashkuara; çështja e popullatës rome është çështje aq me urrejtje në Hungari sa që do të ekzistonte një risk i lartë që të aplikojnë provokuesit.

Kriteri i Seleksionimit

Roli i testuesve është shumë i rëndësishëm, kërkesat në vijim duhet të plotësohen, dhe kjo arrihet me anë të pjesëmarrjes së individëve.

- Dosja kriminale e pastër: Pikësëpari e kaluara e secilit testues duhet të jetë e pastër. Ekziston mundësia që testuesit të ftohen në gjyq si dëshmitar dhe nëse ata kanë dosje kriminale atëherë mund ta zvogëlojnë kredibilitetin e tyre.
- Objektiviteti: Testuesi nuk mund, ose nuk duhet të ketë ndonjë interes vetanak në rezultatet e testimit, ose ndonjë relacion as me të pandehurin e as me palën paditëse.
- Besueshmëria: Duke marrë në konsideratë që procesi gjyqësor mund të zgjasë disa vite, ata duhet të jenë të gatshëm të qëndrojnë në kontakt me programin e testimit për një periudhë të zgjatur kohore. Ne jemi në gjendje të gjejmë ndjenjën subjektive të besueshmërisë së njerëzve gjatë trajnimit të tyre një ditë. Ne gjithashtu sigurojmë që të gjithë trajnuesit në qoftë se vendoset të shkohet më tej me rastin, atëherë rasti do të varet nga gatishmëria e tyre për të dëshmuar, edhe nëse rasti merr disa vite për të dalë në gjyq.
- Përpikëria: Ata duhet të jenë observator të mirë, të aftë që të vërejnë çdo aspekt relevant të trajnimit të tyre, gjatë përvojës së testimit dhe më vonë thirrjes dhe dokumentimit të qartë të detajeve të përvojës. Kjo nuk është një shkathtësi e lehtë që mund të matet më përpara, por pas një përvoje të testimit koordinatori mund ta gjykojë këtë.

Si plotësim të kriterit teknik, testuesit gjithashtu duhet të konsiderojnë nëse ata janë në aspektin psikik të përgatitur për këtë detyrë, e cila mund të jetë e pakëndshme, ndonjëherë edhe e frikshme. (shiko me poshtë: Përvojat dhe shqetësimet e testuesve).

Trajnimi i Testuesve

NEKI siguron trajnim në dy faza për testuesit. Pas rekrutimit të testuesve potencial ne organizojmë trajnim një ditë në grup. Atëherë kur testimi i situatës rritet në përgjigje të palës paditëse, ne organizojmë një sesion përgatitor për raste të veçanta përfshirë vetëm ata testues të cilët do të marrin pjesë.

Trajnimi Një Ditë

Trajnimi i parë është ai një ditë i cili ka për qëllim t'ia paraqes dhe t'ia njoftojë ata me metodologjinë. Kjo nuk është vetëm një përgatitje me rendësi, por ju jep testuesve gjasë që të vendosin nëse kjo është detyrë që ata ndihen të aftë për ta bërë dhe lejon koordinatorët tonë të testimit të gjykojnë nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e zgjedhjes. Trajnimi i parë ka përfshirë 15-20 persona dhe ka plotësuar përmbushjen e formimit të grupit të testuesve. Pas trajnimit të tyre ne kemi pasur një grup prej 30 personave. Nga ky grup ne kemi

mirëmbajtur një bërthamë solide prej gjashtë deri në dhjetë testues për nevojat tona testuese.

Gjatë këtij sesi trajnuar testuesit janë njoftuar me NEKI-in, punën tonë dhe llojin e rasteve dhe në cilat raste mund të përdoren. Ne kemi prezantuar versionin e përkthyer të videokasetës që përshkruan metodën e testimit, e përdorur nga Komuna për strehim të pa anshëm në Uashington. Atëherë testuesit mësojnë hap pas hapi tërë procedurën e testimit, përfshirë këtu shqyrtimin e kujdesshëm të pyetësorëve që nga ata kërkohet t'i plotësojnë pas secilit test (shiko Aneksin 1, Formular të Pyetësorit). Testuesit gjithashtu kanë gjasa të mësojnë për procedurën ligjore që mund të iniciohet në bazë të rezultateve të testimit, dhe se si mundet testimi të përdoret për t'i fuqizuar të drejtat civile. Ne kemi konstatuar që pjesa më e dobishme e trajnimit ishte sesi i detajuar pyetje-përgjigje.

Testuesit duhet të kuptojnë në mënyrë të qartë rolin e tyre në testim dhe procedurën ligjore pasuese. Nëse NEKI inicion procedura ligjore bazuar në rezultatet e testimit, pritët që testuesit të japin deklaratë në gjyq. Pasi që ne nuk mund të punojmë me testues për deklaratën e tyre, ne mundësojmë që ata të jenë të informuar rreth secilit detaj të procedurës gjyqësore, përfshirë kohëzgjatjen e procedurës dhe pyetjet e mundshme me të cilat ata mund të ballafaqohen. Në rastin e fundit, testuesi ka njoftuar që nuk dëshiron të shkojë më shumë se një herë në gjyq, sepse nuk kishte kohë, dhe nuk dëshiron të takohej me të pandehurin në gjykim. Ishte e evidente që ne nuk e kemi informuar atë me informata të mjaftueshme lidhur me procedurën ligjore. Ne tentuam që ta bindim atë për të marrë pjesë në gjykim, por kjo ishte e rrezikshme. Ne tani i kushtojmë më shumë vëmendje përgatitjes së testuesve potencial.

Trajnim i testuesve lidhur me rastin-specifik

Kur NEKI pranon ankesë specifike, për testuesit mbahet trajnim i dytë të cilët do të dërgohen në vendin e supozuar të diskriminimit. Kjo përgatitje është esenciale dhe e rëndësishme pasi që testuesit duhet të kuptojnë specifikat e situatave speciale të veçanta. Ata përfitojnë gjithashtu duke i rikujtuar parimet bazë të prezantuara në sesionin e parë trajnuar.

Koordinatori i testit takon qiftin e testuesve (romë dhe jo romë), i njofton ata për dëshminë që NEKI është duke hetuar dhe i pajis me informata të nevojshme që ata duhet t'i dinë më përpara (adresën e lokacionit, numrin e telefonit, emrat, etj). Me ndihmën e Koordinatorit, testuesit e

lexojnë pyetësorin dhe përgatiten për detyrë specifike. Varësisht nga ankesa, ekzistojnë lloje specifike të informatave që ne dëshirojmë që testuesit të pajisen me to. Për shembull, në rastet kur romët nuk lejohet të futet në bar ose restorant, testuesit duhet të gjejnë arsyen për një refuzim të tillë. Në disa raste, roja e sigurimit haptazi ka treguar që të dyve, palës paditëse dhe pastaj testuesve që pronari nuk lejon romët, sepse ata shkaktojnë probleme. Testimi siguron më shumë dëshmitarë të diskriminimit të tillë si këto, për të bërë më të lehtë diskriminimin në gjyq që diskriminimi është bërë.

Kontrast

Puna e testuesve është përcaktuar në kontratë, e nënshkruar në mes të testuesit dhe NEKI-it. Në këtë kontratë, testuesi pajtohet si në vijim:

- Testuesi do ta kryej testimin në vendin e përcaktuar.
- Brenda 20 minutave të testimit, testuesi do të plotësojë pyetësorin
- Gjatë testimit, testuesi do të sillet normalisht dhe nuk duhet të shpreh opinionin e tij/saj. Kur plotëson pyetësorin, testuesi do të përshkruaj situatën në detaje.
- Në rast se para, gjatë, ose pas testimit diçka e paparashikueshme ndodhë, atëherë testuesi do të kontaktojë menjëherë koordinatorin e testit.
- Në rast të procedurës ligjore, testuesi do të paraqitet para autoriteteve dhe do të dëshmojë rreth përvojës së tij/saj.
- Testuesi nuk do të zbulojë ose tregojë rezultatin e testit palës tjetër. Para dhe pas testimit, testuesit nuk do të japin informata lidhur me testimin palës tjetër pa lejen e NEKI-it.
- Testuesit duhet ta vijojnë instruksionin e Koordinatorit të testit.
- Në të njëjtën kontratë, NEKI pajtohet si në vijim:
- NEKI do të sigurojë ndihmë legale për testim që është e nevojshme në relacion me testimin.
- NEKI nuk do të zbulojë ose tregojë informata palës tjetër rreth testuesve pa lejen e tij/saj.
- Kësti për testim: Pas testimit NEKI do të paguaj Testuesin 5,000 HUF. Në rast të procedurës gjyqësore, NEKI do të paguaj 5,000 HUF për një ditë, që t'i kompensojë testuesit për ditën e punës së humbur.

Përvojat dhe shqetësimet e Testuesve

Të qenit Testues nuk është e lehtë, e as nuk është gjithnjë ndjenjë e këndshme. Për shembull, B. Berkes, një nga testuesit tonë, ka folur për përvojën e saj të testimit në një bar të

popullarizuar në Budapest në Gusht të vitit 2002:

"Edhe pse unë isha e përgatitur për një refuzim të mundshëm, ndjenjën që e kam pasur në hyrje ishte më shumë poshtëruese sesa që kam pritur. Gjatë tërë kohës isha duke menduar për situatën dhe prezencën time atje me miqtë romë dhe jo romë. Nuk di sesi do të kisha reaguar në situatë të vërtetë".

Nuk është a pazakonshme që testuesit të kenë përzjerje të ndjenjave lidhur me përvojën – posaçërisht të testuesit romë. Është e logjikshme që pjesëmarrja në testim është zgjedhje e qëllimtare për të marrë pjesë në një situatë të tillë ku njerëzit do t'ju poshtërojnë. Popullata romë, dhe anëtarët e minoriteteve të tjera që ballafaqohen me diskriminim, vazhdimisht ballafaqohen me këtë poshtërim dhe ata nuk kanë nevojë për këtë. Çdo instancë e poshtërimit është personalisht dëmtuese, edhe atëherë nëse është futur në të për qëllim të mirë. Por edhe testuesi nuk ka "dëshirë" ta bëjë këtë, por ata do të raportojnë një ndjenjë kënaqësie kur testimi është i suksesshëm – kur ata ndjejnë që NEKI ka marrë evidencë të nevojshme për të avokuar të pandehurin.

Shqetësime të ngjashme rriten edhe gjatë sesionit përgatitor të testuesve: Çka të bëjë nëse do të fyhem, kur shqetësohem, sulmohem? Çka nëse dëgjoj komente raciste? anëtarët e stafit të NEKI-it gjithnjë theksojnë që testi nuk është aq i rëndësishëm si individual, dhe i inkurajojnë testuesit që ata të kujdesen për sigurinë e tyre personale dhe shëndetin psikik. Testuesit do të nxiten dhe do të jenë të këmbëngulës që ndaj fyerjeve të reagojnë në mënyrë pasive, dhe të ikin sa më parë nëse ata ndihen të cenueshëm. Ata janë të vetëdijësuar që të mos përfshihen në përlëshje ose debate të nxehta që mund të shpijnë në dhunë. Ata këshillohen që të përdorin gjykimin e tyre dhe të përcaktojnë zgjidhjen më të mirë në situatë të tilla.

Një shqetësim tjetër i rëndomtë shfaqet nga nevoja eventuale për testuesit të dëshmojnë në gjyq. Pasi që shumica e njerëzve nuk kanë përvojë me gjykatat, ata ndihen të frikësuar nga sistemi gjyqësor, posaçërisht nëse ata janë anëtarë të minoriteteve që ballafaqohen me trajtim jo të barabartë nga sistemi ligjor.

Pavarësisht nga këto shqetësime, individët vazhdojnë të marrin pjesë në teste. Ata ndihen shumë mirë për kontributit e tyre që e japin në procesin gjyqësor, dhe raportojnë përvojat

inkurajuese nga salla e gjyqit. Një testues – absolvent i Fakultetit Juridik – ka zgjedhur të vijë dhe të punojë me NEKI-in si punonjës i brendshëm.

Zbatimi, vënia në jetë e testimit

Atëherë kur NEKI pranon një ankesë, ne vendosim nëse do ta iniciojmë testimin. Shumica e ankesa nuk gjykohen ose konsiderohen të qenit incidente të diskriminimit. Për ato raste që përfaqësojnë ankesa të vlefshme të diskriminimit (rreth 30 për vit), ne së pari mbledhim të gjitha shënimet e mundshme rreth situatës. Kjo vetë gjetje e fakteve ndonjëherë mund të ketë një ndikim pozitiv. Ne mund ta adresojmë një letër të autoritetet lokale ose të pronarët e një kompanie ofenduese, dhe ata mund të bëjnë ndryshime pa ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm ligjor. Kur ne besojmë që testimi do të ndihmojë në mbledhjen e evidencave për procesin gjyqësor potencial, vendimi për test zakonisht duhet të bëhet shumë shpejtë. Për shembull, në rast se kur ndokush ka qenë i refuzuar për punë, testimi do të jetë i efektshëm nëse dërgojmë kandidatë potencialë në ndërkohë që vendi i lirë është ende në dispozicion, pasi që është esenciale që ata do të aplikojnë për të njëjtin vend të punës nën kushte të njëjta në mënyrë që përvojat e tyre të konsiderohen relevante në aspektin ligjor me përvojën e të pandehurit origjinal. Andaj, kur vendosim të implementojmë një test, shumë shpejt zgjedhim testuesit, e trajnojmë atë dhe e planifikojmë testin.

Atëherë testuesit dërgohen në vendin ku pretendohet të ketë pasur diskriminim. Ata regjistrojnë përvojat e tyre duke plotësuar pyetësorët, menjëherë pas përfundimit të testit, duke raportuar të gjitha detajet e trajtimit të tyre. Koordinatori i testit pastaj mund të vlerësojë nga këto shënime nëse ka pasur trajtim diskriminues, dhe vendos nëse një veprim ligjor mund të iniciohet.

Procedura e përfshirë, lidhur me zbatimin dhe implementimin e testimit:

- Mbledhja e shënimeve, dhe vendosja nëse është e dobishme përdorimi i testimit në rastin specifik
- Zgjedhja e qiftit të testuesve (romë dhe jo romë)
- Mbatja dhe realizimi i trajnimit mbi rastin specifik me testuesit
- Nënshkrimi i kontratës me testuesit
- Ti bëjë testuesit që të kthehen në zyre dhe t'i plotësojnë pyetësorët
- Vlerësimi i shënimeve që rezultojnë nga testet.

Shembull: Rasti Lajos Balogh

Ndoshta mënyra më e mirë për ta kuptuar përdorimin e testimit është përmes shembullit specifik të përdorimit të tij.

Pavarësisht nga fakti që ende nuk ka paragjykim final në ndonjë nga rastet e diskriminimit të punësimit në Hungari, rasti i Lajos Balogh-it vlen që të shqyrtohet në detaje. Rezultatet e testimit ishin të qarta dhe të prera dhe rasti paraqet çdo hap të procedurës së testimit. Rasti ishte gjithashtu i rëndësishëm sepse Kodi i Punës është i vetmi ligj në Hungari me dispozita adekuate të anti-diskriminimit. Pasi që këto dispozita nuk janë kërkuar më parë para këtij rasti, ne kemi konsideruar të rëndësishme që të luaj rol në interpretimin dhe aplikimin e tij.

Ankesa

Lajos Balogh kishte ndërprerë studimet e tij në kolegji për shkak të kushteve financiare dhe kishte shikuar të punësohej. Në shkurt të vitit 1999, pasi që kishte lexuar shpalljen në gazete për vend të lirë pune, ai kishte aplikuar për punë përmes telefonit. Kompania T kërkonte persona për të shpërndarë fletushka. Operatori i tregoi aplikuesit që kishte vende të lira pune dhe e ftoi atë për një intervistë personale. Pasi që kishte arritur në zyre, nga ai kërkohet që ta plotësonte formularin me informata dhe detaje personale të tij. Si përgjigje ndaj kërkesës së tij, kishte deklaruar që një punë të ngjashme e kishte bërë edhe më parë. Pyetje tjetër nuk i është adresuar atij, dhe është kërkuar nga ai që ta kontaktonte kompaninë pas dy dite. Z. Balogh shkoi vetë personalisht në zyre dhe pretendon që kishte parë në aplikacion e tij fjalët e shënuara "maxhup, cigan" të shkruar me shkronja të shtypit. Formulari nuk i është kthyer, në prezencë të tij është hedhur në shportë. Për të vërtetuar këtë rast tipik të diskriminimit ne kemi vendosur të testojmë procesin e rekrutimit.

Fazat/Hapat e testimit

Përgatitja e testuesve

Koordinatori i testit zgjedhë dy qifte të testuesve me karakteristika të njëjta me të atyre të palës paditëse të nacionalitetit rom. Të gjithë janë studentë dhe nevojtarë për të ardhura. Para se të dërgohen në terren, koordinatori i fton në zyre dhe i pajisë me informata të nevojshme për zbatimin e testimit. Testuesit janë të njoftuar me ngjarjen

origjinale të palës paditëse dhe u jepen instruksione precize me ndihmën e pyetësorit, të cilin ata duhet ta kompletojnë pas testimit. Ata gjithashtu janë informuar rreth mundësisë së dëgjimit të tyre në gjyq, dhe mundësisë që ata të jenë të ftuar për të dhënë dëshmi dhe deklarata lidhur me përvojat e tyre.

Ne kemi pyetësor të përgjithshëm të aplikueshëm për raste të ndryshme dhe këta pyetësorë ndryshohen për çdo rast specifik. Është e rëndësishme për secilin testues që të informohet paraprakisht se cilat detaje janë të nevojshme që duhet t'i kushtojnë mendësi, cilat pyetje mund t'i hasin gjatë intervistës dhe posaçërisht pyetjet që posaçërisht jemi të interesuar që të marrim nga këto përgjigje.

Përvoja e testereve

Dy testet e para kanë aplikuar për vend të punës me 29 Prill 1999, që është përsëritur në afat kohor shumë të shkurtër pas aplikimit të palës paditëse. Testuesi i parë rom thërret firmën, shoqëruar me testuesin e dyte jo rom pas gjysmë ore. Ata shkojnë dhe e shqyrtojnë vet rastin. Që të dy plotësojnë dhe mbushin aplikacionin dhe nga ata kërkohet që të thërrasin prapë më vonë. Qifti tjetër i testuesve aplikon më vonë pas disa ditëve. Të katërtit kanë thirr kompaninë dhe kanë zbuluar që dy pjesëtarët jo romë janë ftuar për rekrutim, përderisa dy pjesëtarët romë nuk janë ftuar fare.

Testuesit e rekrutuar kanë nënshkruar kontratë dhe pastaj ata janë pajisur me fletushka për t'i shpërndarë ato. Për t'u siguruar më mirë rasti i diskriminimit, ne kërkuam nga testuesit që mos ta kryejnë punën por t'i kthejnë fletushkat me arsyetim që puna ishte shumë e ngatërruar. Po në këtë ditë ne dërguam një testues tjetër rom, pasi që e dinim se atje ka nevojë për të kryer këtë punë. Ai ka plotësuar formularin dhe gjithashtu ishte refuzuar nga kompania me anë të telefonit. Deri në këtë moment, firma kishte refuzuar të punësonte katër pjesëtar romë për të cilët kishin nevojë dhe nuk kërkohesh as shkathtësi profesionale e as edukim i lartë.

Vlerësimi i pyetësorëve dhe vijimi i tyre

Testuesit pas çdo testi kthehen dhe plotësojnë pyetësorët në detaje lidhur me përvojën e tyre. Për secilin rast, NEKI duhet të analizojë këtë informacion dhe vendosë nëse kjo ofron evidencë të qartë të diskriminimit. Nëse nuk gjejmë evidencë të mjaftueshme, duhet të informojmë palën paditëse që nuk mundemi të procedojmë

me këtë rast. Por nëse rezultatet e testimit demonstrojnë diskriminimin, atëherë ne mund të iniciojmë aktin ligjor. Në rastin e Lalos Balogh, rezultatet e testimit ishin shumë përmbajtësore dhe siguronin evidencë të dobishme. Në emër të origjinalit të palës paditëse, NEKI plotëson një padi kundër kompanisë duke u referuar në sesionin 5 të Kodit të Punës. Ankuesi është palë paditëse origjinal të cilit i janë shkelur të drejtat themelore të njeriut dhe pesë testuesit mund të dëshmojnë rreth praktikave diskriminuese të procesit rekrutues të kompanisë. Në shikim të parë rasti nuk duket shumë i komplikuar. Ekziston evidencë e fortë që mund të

vërtetojë diskriminim, testuesit janë të gatshëm të japin dëshmi dhe deklarata objektive sa i përket përvojave të tyre dhe avokatë të mirë të njohur të të drejtave të njeriut e përfaqësojnë ankuesin edhe nëse kompania nuk ka përfaqësim ligjor. Sidoqoftë, ky proces ka zgjatur tre vite për gjyqin për të përcaktuar nëse rasti kategorizohet nën këtë juridiksion. Gjykimi mbi meritat e rastit ende as nuk ka filluar. Gjykimi final i kësaj është ende shumë larg, andaj ne nuk mund të predikojmë rezultatit e procedurës ose reagimin e gjyqtarit lidhur me rezultatet e testimit.

Rezultatet

Deri më tani, NEKI ka dërguar në terren testuesit 15 herë. Në tri raste nuk ishte e mundur të kompletohej testi, për arsye të ndryshme. Nga 12 testet e kompletuara, pesë prej tyre nuk kanë evidentuar diskriminim sistematik. Shtatë rastet e mbetura kanë provuar dhe demonstruar diskriminimin e mjaftueshëm për të filluar procesin gjyqësor. Nga këto raste, NEKI ka iniciuar gjashtë raste të diskriminimit. Tri nga këto janë ende të pezulluara, të pa zgjidhura.

Nga tre rastet e kompletuara, duke përdorur testimin, i kemi fituar dy raste dhe një rast është humbur. Testuesit janë paraqitur në gjyq secilën here dhe evidenca e tyre është pranuar nga gjykatësi pa diskutim ose pa i marrë në pyetje. NEKI beson që shënimet ishin element esencial dhe kryesor në këto fitore. Në rastin e tretë, gjykatësi ka arritur në përfundim që testimi i evidencës, meqenëse jo i qartë, nuk ka vërtetuar që ankuesi kishte përjetuar diskriminim.

NEKI është e vetmja avokaturë në Hungari që përdorë këtë taktik. Avokatë të të drejtave të njeriut ka, sidoqoftë, rastet referohen te NEKI atëherë kur kuptohet që testimi duhet të jetë esencial në grumbullimin e evidencës.

Përdorim i testimit për negociim jashtë-gjyqit

Në një rast kur testimi ka demonstruar

diskriminim, NEKI nuk ka iniciuar procedurë ligjore. Në vend të kësaj, ne kemi shkuar te i pandehuri për të negociuar një ujdj jashtë gjyqësore. Ne kemi përshkruar rastin e palës paditëse dhe të dhënat e testimit të të pandehurit ku avokati ka pranuar fuqinë e rastit tone. NEKI tashmë ka fituar rastet gjyqësore me përdorimin e evidencës së testimit. I pandehuri dëshironte ta mënjanonte gjyqin, ndërsa NEKI dhe pala paditëse ishte e interesuar në shpejtimin e zgjidhjes. Palët ishin të gatshme të negociojnë një marrëveshje brenda tre muajve. Në marrëveshjen finale, i pandehuri kërkoi falje publikisht, pushoi nga puna punonjësit abuzues dhe i pagoi kompensimin viktimës – kompensim pesë herë më i lartë sesa cilido fitim në raste të ngjashme në gjyq.

Në rastet e fundit, paditësi ka përjetuar diskriminimin në hyrje të një klubi shumë të njohur në Budapest. Pasi që incidenti ka përfshirë një numër të dëshmitarëve, testimi nuk ishte i nevojshëm. NEKI ka ftuar pronarin dhe ka propozuar një negociim. Edhe pse pronari ishte i hapur ndaj kësaj çështje, ai dëshironte të debatonte lidhur me rastin. Sidoqoftë NEKI nuk do të negociojë mbi faktet e rastit – mbi atë nëse diskriminimi ka ndodhur – por vetëm mbi marrëveshjen. Andaj në këtë rast, negociatat ishin përfunduar dhe rasti do të sillet në gjykatë.

NEKI pret që testimi mund të vërtetojë dhe dëshmojë më shumë dhe është shumë i dobishëm në rastet të cilat janë të mundshme të negociohen pa procese gjyqësore.

Aplikimi i taktikës për rastet gjyqësore : Çështjet e rëndësishme që të duhet të merren parasysh

Sipas përvojave tona, pa ndihmën e një organizate me aftësi të mira, me resurse dhe me aftësi legale, do të ishte e pamundur që rastet e diskriminimit në Hungari të dalin në gjykatë. Kjo është një shenjë e qartë që ligji Hungarez i diskriminimit nuk është efektiv dhe nuk shërben për interesa të viktimave, apo të shkeljeve të drejtave të njeriut. Nëse ballafaqoheni me situatë të ngjashme në vendin tuaj, ku diskriminimi mbizotëron dhe viktimat dhe avokatët e tyre kanë vështirësi që të dëshmojnë këtë në gjyq, mund të konsideroni që të argumentoni përpjekjet tuaja me taktikë të testimiit e cila është përshkruar këtu. Ne shpresojmë që përshkrimi i përpjekjeve tona do t'ju japin disa ide të qarta të hapave që do të merren dhe në mënjanimin e kurtheve, posaçërisht në aspekte të seleksionimit, trajnimit dhe përdorimit të testuesve. Ne gjithashtu sugjerojmë që t'i merrni në konsideratë disa pyetje shtesë dhe mësimet që kemi nxjerrë nga përvoja jonë.

Ligjet diskriminuese: Përdorimi i testimiit për qëllime ligjore natyrisht do të duhet të jetë në përputhje me specifikat e ligjeve kombëtare mbi diskriminimit. Deri në masë që një shtet gjithashtu pranon juridiksionin e ligjit ndërkombëtarë, kjo gjithashtu mund të jetë bazë për veprim ligjor mbi diskriminimin. Çfarëdo qoftë korniza ligjore, rastit që orvatet të dëshmojë diskriminimin zakonisht i nevojitet evidencë ku tregon që një incident nuk është një episod i vetëm, por një shembull i sjelljes së diskriminimit sistematik. Metoda e testimiit mund të jetë një metodë e fuqishme e gjenerimit të një evidence të tillë.

Resurset: Metoda e testimiit që NEKI ka zhvilluar për të siguruar evidencë të diskriminimit është e kushtueshme si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin financiar. Kjo kërkon një aranzhim organizativ me një zyrë të pajisur mirë, një koordinator të testimiit të trajnuar mirë dhe testues të trajnuar. Në mënyrë që të shfrytëzohen rezultatet e testimiit në procesin gjyqësor, këto investime duhet edhe më tej të përkrahen nga juristët profesional të cilët janë të gatshëm të

marrin rastet lidhur me diskriminimin përmes sistemit gjyqësor. Kush do të jetë paditësi? Në rastin kur testimi zbulon diskriminimin, që të dy, paditësi dhe testuesit do të ndjejnë një shkelje. Edhe pse testuesit mund të kalojnë nëpër një trajtim të turpëruar gjatë testimiit, qëllimi i tyre është ndryshe nga ajo e kandidatit fillestar. Në rastet diskriminuese të punësimit, testuesit nuk janë nevojtar për punë, ata janë të punësuar nga NEKI dhe ata vetëm testojnë praktikën e rekrutimit. Si pasojë, nuk ekziston bazë ligjore për t'i përfshirë ata në procedura si paditës. NEKI në këtë mënyrë inicion procedurat ligjore vetëm në emër të paditësit origjinal, i përdorë dëshmitë e testuesve si evidencë.

Situata në rastet e strehimit publik është e ndryshme. Në disa instanca NEKI ka iniciuar rastet gjyqësore të dy, si për paditësin origjinal ashtu edhe për testuesit. Qëllimi i testuesve këtu nuk dallohet shumë nga ajo e paditësit origjinal dhe testuesit tregojnë të vërtetën rreth dëshirës që të futen në vende publike. Në rastin e fundit, testuesit romë kanë kërkuar nga NEKI, që t'i përdorin ata si paditës sepse janë ndër të fyer dhe të turpëruar kur kanë dëshiruar të kenë qasje në ato vende dhe haptazi ishin refuzuar për shkak se ishin me origjinë romë. Ky peticion civil është në përgatitje dhe reagimi i gjyqit ndaj pozitës ligjore të testuesve nuk mund të gjykohet ende.

Llojet e rasteve: Ne kemi pasur një përvojë pozitive duke përdorur mjetin për të konfrontuar diskriminimin në punësim, banim, dhe strehim publik. Pranimi i dëshmitëve të testuesve nga ana e gjykatës mund të interpretohet në mënyrë që testimi në vete tash konsiderohet si një metode ligjore e pranueshme që demonstroi diskriminimin.

Llojet e viktimave: NEKI merret me rastet diskriminuese raciste, kryesisht me popullatën romë që jeton në Hungari. Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë diskriminime të tjera, siç është gjinia, raca, gjuha, religjioni, dhe opinioni politik. Mbrojtja ligjore është e nevojshme në të gjitha këto raste. Nëse metoda e testimiit funksionon në rastet e diskriminimit racor, kjo gjithashtu duhet të funksionojë edhe në llojet e tjera të rasteve. Pasi që rezultatet e testimiit dhe procedurat gjyqësore pasuese në Hungari raportohen në media, është e mundur që organizatat e tjera të të drejtave të njeriut do të provojnë metodën në rastet e tyre personale dhe profesionale.

Përdorimi i taktikës së testimit në mënyra tjera

Testimi mund të jetë taktikë e dobishme për mbledhjen e evidencës si dhe për lobim ose edukim publik. Për shembull në Hungari, është duke u marrë në konsideratë legjislati i ri anti-diskriminues dhe lejimi i OJQ-ve që të komentojnë zyrtarisht, si pjesë i këtij procesi. Komentet e NEKI-it përfshijnë argumentin që nevoja e testimit është në vete një demonstrim i mangësive të ligjit aktual anti-diskriminues. NEKI përpilon një raport publik vjetor ku thekson punën e saj, rastet dhe rezultatet nga përvoja e testimit të tyre. Për disa raste, zakonisht në fazat e vonshme të procesit gjyqësor, NEKI gjithashtu raporton evidencën e testimit në media. Ky publicitet kontribuon në edukimin publik rreth nevojës për të eliminuar diskriminimin.

Ne kemi mësuar shumë gjëra përmes përvojave tona me testimin. Jemi të bindur që ka më shumë vende në Hungari ku praktikë diskriminuese zënë vend. Krahasuar me shtrirjen e problemit të vërtetë ende janë vetëm disa njerëz që kërkojnë ndihmë nga NEKI. Deri sa NEKI shfrytëzon testimin kur pranon ankesën për diskriminim,

është e sigurt që një taktikë e tillë mund gjithashtu të përdoret edhe për qëllime të tjera :

- Testimi mund të përdoret në mënyrë aktive për të demonstruar dhe publikuar praktikë diskriminuese në një industri ose kompani. Aplikimi më i gjerë i taktikës, për shembull, mund të përfshijë zbatimin e testimit pa një ankesë origjinale, në mënyrë që të identifikohet nëse një industri në mënyrë sistematike i diskriminon njerëzit në bazë të nacionalitetit, racës, gjinisë ose aftësive të kufizuara (siç është AIDS). Rezultatet e këtyre testeve mund të përdoren për lobim të ndryshimit të praktikave përmes proceseve gjyqësore pasuese ose për edukim publik.
- Testimi gjithashtu mund të përdoret për të ekspozuar sjelljet raciste në sektorë të veçantë të qeverisë. Një kolegë rus, për shembull, ka sugjeruar që të testohen praktikë e rekrutimit në vendlindjen e tij kur një kaukazian aplikon në akademinë policore.
- Testimi gjithashtu mund të zbatohet në forma më gjithëpërfshirëse që të vërtetohet ekzistenca e diskriminimit në një fushë dhe që organizatat të cilat bëjnë diskriminim të mos përdorin praktika të tilla. Mund të bëhet një numër i testeve për të shikuar nëse njerëzit e racave të ndryshme janë trajtuar ndryshe në situatë ku ngacmimi ose diskriminimi ka ndodhur shpesh, siç është ecja ose vozitja në vende të caktuara.

Përfundim

Situata në Hungari nuk është unike. Diskriminimi paraqitet në forma të ndryshme dhe kjo dukuri është e përhapur në shumicën e shoqërive në botë. Ky problem është gjithëpërfshirës, në fakt, që shumë vende – ndoshta shumica – kanë ca korniza për konfrontimin e kësaj shkeljeje të të drejtave, e cila nuk është e tolerueshme me ligj ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Metoda e testimit përdorë një kornizë ligjore të tillë, por gjithashtu pranon që ligjet kombëtare anti-diskriminuese nuk janë të dizajnuara mjaftueshëm për të mbrojtur viktimat (në fakt ndonjëherë ligji në mënyrë të drejtpërdrejtë mbron autorët e krimit duke e vështirësuar

procesin në gjykatë). Aty ku ligjet ekzistojnë ato shpesh nuk zbatohen, dhe shpesh nxjerrja e fakteve është sfidë pothuajse e pamundur.

Ne besojmë që mjeti i testimit mund të na sjell në një hap të rëndësishëm për plotësimin e kësaj sfide edhe pse ky hap mund të jetë i vogël. Me përdorim të gjerë, do të promovojmë dhe inkurajojmë më shumë procese gjyqësore kundër diskriminimit. Përfundimisht kjo do të na shpie më afër kulturës që respekton të drejtat e njeriut. Mjeti i testimit, na ka ndihmuar në Hungari. Shpresojmë që ky material do të jetë i dobishëm në punën tuaj personale dhe profesionale.

• **Shenimet** •

• **Shenimet** •

• **Shenimet** •

**For a full list of publications available in the Tactical Notebook Series,
go to www.newtactics.org.**

Online you will also find a searchable database of tactics and
forums for discussion with other human rights practitioners.



The Center for Victims of Torture
New Tactics in Human Rights Project
717 East River Road
Minneapolis, MN 55455
cvt@cvt.org

